

# MANUALI TEKNIK

## PËR MONTIMIN E TJEGULLAVE QERAMIKE

## PRO 10






## PROCEDURA E MONTIMIT

Mbulesa e çatisë shërben për të mbrojtur ndërtesat nga efektet e natyrës meteorologjike (shiu, bora, era), zjarri dhe vjedhjet me thyerje. Zgjedhja e mbulesës së çatisë varet nga: pjerrësia e sipërfaqes së çatisë, zona klimatike dhe kushtet arkitekturore. Tjegullat, për shkak të pozicionit të brazdës, duhet të renditen nga e djathta në të majtë në rreshta, nga streha deri në kreshtë. Për të kompletuar mbulesën, rekomandimi i prodhuesit është përdorimi i elementeve speciale prej argjile (tjegulla ventiluese, elemente përfundimtare majtas dhe djathtas, kulmorë, kulmorë fillestar dhe kulmorë trekëndor të brinjëzuar) dhe aksesoreve për çati (shiriti për kurorë dhe kreshtë, bartësit e listelës për kurorë dhe kreshtë, fiksuesit për kulmorë, mbrojtëse metalike për dëborë, foli për çati e përshekueshme nga avulli, ndërsa e papërshekueshme nga uji, rrjetë për mbrojtje nga zogjët, krëhër për çati, complete ventilimi...).

## REKOMANDIMI I PRODHUESIT:

1. Përcaktimi i distancës së listelave
2. Montimi e kulmorëve tek linjat horizontale dhe të pjerrëta të mbylljes së çatisë
3. Sistemi për mbrojtje nga dëbora - mbrojtëse qeramike të borës ose mbrojtëse metalike të borës
4. Sistemi ventilues - tjegulla qeramike ventiluese
5. Pajisje sistimore
6. Manuali për realizimin e mbulesës së çatisë



## VENDOSJA E DUHUR E LISTELAVE PËR ÇATI

### PËRCAKTIMI I DISTANCËS SË LISTELAVE

e : distanca e listelave

n : numri i përgjithshëm i listelave të çatisë

A - distanca nga pika e kreshtës

Gjatësia e listelave nëse dihet gjatësia e listelës së kundërt


$$e = (L - 38\text{cm} - A) / (n - 1)$$

| Pjerrësia | A (cm) |
|-----------|--------|
| 15° - 20° | 5,0    |
| 21° - 25° | 4,5    |
| 26° - 30° | 4,0    |
| 31° - 35° | 3,5    |
| 36° - 40° | 3,0    |
| 41° - 45° | 3,0    |
| >45       | 3,0    |

**TJEGULLA PRO 10:**

Kontinent, Tradicional dhe Horizont - Distanca e listelave (e) nga 36,5 deri në 40,5 cm  
Pjerrësia e rekomanduar e çatisë min 15°

Maestral - Distanca e listelave (e) 40,5 cm  
Pjerrësia e rekomanduar e çatisë min 22°



### Punimet para vendosjes së listelave:


- kontrolloni nëse pjerrësia e strukturës së çatisë korrespondon me kushtet për vendosjen e tjegullave

### Vendosja e tjegullave:

- përcaktojmë pozicionin e listelës së sipërme dhe e fiksojmë atë
- përcaktojmë pozicionin e listelës së poshtme dhe e fiksojmë atë
- përcaktojmë pozicionin e listelës së dytë nga streha
- përcaktojmë pozicionin e listelave të tjera dhe i vendosim ato
- kontrollojmë nëse listelat janë pingul me brirë (këndi 90°)


## MONTIMI I DUHUR I ELEMENTEVE SPECIALE

### 1. MONTIMI I KULMORËVE TË BRINJËZUAR NË LINJËN HORIZONTALE (KULMORË) DHE TË PJERRËT (KRESHTË) TË MBYLLJES SË ÇATISË



#### Punimet para vendosjes së listelave:

- Kulmorët e brinjëzuar montohen pasi të jetë instaluar listela e kurorës dhe kreshtës.
- Përmasat e rekomanduara për listelën e kurorës dhe kreshtës janë 4x5 cm.
- Listela për kurorë dhe kreshtë vendoset mbi bartësit e listelës për kurorë dhe kreshtë.
- Kulmorët e brinjëzuar montohen nga drejtimi i erës (secili kulmorë duhet patjetër të vidhoset në listelë me fiksues për kulmorë)




## 2. SISTEMI VENTILUES - TJEGULLA QERAMIKE VENTILUESE

Tjegullat ventiluese shërbejnë për ventilim efektiv të çatisë, gjë që eliminon shfaqjen e kondensimit dhe grumbullimit të lagështirës. Vendosen për:

për hyrjen e ajrit N1 - në rreshtin e dytë nga fundi (nga streha)

për daljen e ajrit N2 - në rreshtin e dytë nga lart (nga kreshta)



### Numri i copave të tjegullave ventiluese:


- për hyrjen e ajrit -  $N1 = n \cdot 0,33$
- për daljen e ajrit -  $N2 = n \cdot 0,33$
- $n$  - numri i tjegullave në një rresht

## MONTIMI I DUHUR I AKSESORËVE TË ÇATISË


### SISTEMI PËR MBROJTJE NGA DËBORA - MBROJTËSE METALIKE TË BORËS

Mbrojtësit e dëborës parandalojnë që masat e mëdha të borës të rrëshqasin nga çatia kur vjen deri tek shkrija. Vendosen pranë strehës mbi tjegullat ventiluese të çatisë për të mundësuar ventilimin e duhur të çatisë gjatë dimrit.


Renditja e mbrojtëseve të dëborës varet nga lartësia mbidetare dhe pjerrësia e çatisë.




për LM deri në 300m =  
3 copa/m<sup>2</sup>



për LM nga 300 deri në 500m=  
5 copa/m<sup>2</sup>



për LM mbi 500m=  
6 copa/m<sup>2</sup>



për LM veçanërisht të rrezikshme=  
8 copa/m<sup>2</sup>

SKEMA E INSTALIMIT TË MBROJTËSVE TË DËBORËS

## PAJISJET SISTEMORE REKOMANDIMET E PRODHUESIT PËR INSTALIM

### PAJISJET SISTEMORE

|                           |                                       |                                                                   |
|---------------------------|---------------------------------------|-------------------------------------------------------------------|
| <b>KRESHTA E ÇATISË</b>   | Linja e kreshtës                      | Kulmorët e brinjëzuar, bartësit e listelës për kurorë dhe kreshtë |
|                           | Elementet ndarëse                     | Kulmorët trekëndor të brinjëzuar                                  |
|                           | Elementet fillestare dhe përfundimtar | Kulmori fillestar, pllaka PVC përfundimtare                       |
| <b>VENTILIMI I ÇATISË</b> | Kurora dhe kreshta                    | Shiriti ventilues për kurorë dhe kreshtë                          |
|                           | Sipërfaqja e çatisë                   | Tjegullat ventiluese                                              |
|                           | Streha                                | Rrjetë për mbrojtje nga zogjtë                                    |
| <b>ÇATIA DYTËSORE</b>     | IMN Mladost folie për çati            | IMN Mladost folie për çati 150gr                                  |
| <b>SIGURIA</b>            | Mbrojtja nga stuhitë                  | Fiksues për kulmorë                                               |
|                           | Mbrojtja nga dëbora                   | Mbrojtëse metalike të dëborës                                     |

### MANUALI PËR REALIZIMIN E MBULESËS SË ÇATISË

- Gjatë punimit të çatisë, për të marrë nuancën homogjene, përdorni tjegulla nga paleta të ndryshme dhe paketime të ndryshme në të njëjtën kohë
- Vendosni tjegullat nga ana e djathtë e çatisë, nga poshtë lart.
- tjegullat duhet patjetër të fiksohen në skaje, kreshtë, tendë, ndërsa tjegullat e prera me gozhdë ose vidha
- Rekomandime për fiksimin e tjegullave sipas pjerrësisë
  - 15°- 40° - nuk është i nevojshëm fiksimi i tjegullave, me instalimin e detyrueshëm të çatisë dytësore (foli për çati e përshkueshme nga avulli, ndërsa e papërshkueshme nga uji)
  - 40°- 60° - është e nevojshme të fiksohet secila tjegull e dytë ose e tretë me instalimin e detyrueshëm të çatisë dytësore
  - >60°- është i nevojshme të fiksohet secila tjegull